



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 542, datë 23.11.2021**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR VITIN 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT  
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL  
TË GJYQTARES

Tiranë më 23.11.2021

*Ekstrakt*

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE  
NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI.**

**1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

**1.A Njohuritë ligjore.**

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja përcakton dhe përshkruan faktet e çështjes në pjesën e dytë të arsytimit të vendimit, pas parashtrimit të rrethanave procedurale, vlerësimit lidhur me juridiksionin dhe kompetencën, si dhe parashtrimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse.

Përshkrimi i rrethanave dhe fakteve të çështjes, në bazë të kategorisë së çështjes (*marrëdhënie pune ose civile themeli*), është i qartë dhe bëhet duke integruar edhe provat prej të cilave rezultojnë ato. Në një rast gjyqtarja nuk përshkruan faktet e çështjes, për shkak se nisur nga vlera e objektit të kërimit, ka aplikuar nenin 310/II/3 të K.Pr.Civile sipas të cilit: “*Vendimi i gjykatës për paditë me vlerë deri në 150 000 lekë duhet të përmbajë hyrjen dhe pjesën urdhëruese, sipas pikës 1 të këtij neni. Nëse palët, brenda tre ditëve nga njoftimi i këtij vendimi,*

*njoftojnë me shkrim gjykatën se do ta ankimojnë vendimin, gjykata arsyeton vendimin dhe ua njofton palëve”.*<sup>1</sup>

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi në fillim të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimit. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet e vëzhguara rezultojnë se përgjithësisht gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar dhe herë pas here duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil, të Kodit Punës dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete.

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën hyrëse dhe në përmbajtje të arsytimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 36, 41, 43, 45, 48 dhe 59 të K.Pr.Civile lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor civil, si dhe kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes civile ose të marrëdhënieve të punës;
- nenin 32 të K.Pr.Civile lidhur me të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për t’u dëgjuar mbi themelin e pretendimeve në lidhje me një mosmarrëveshje të caktuar/legjitimitimin formal të palës paditëse në ngritjen e padisë;<sup>2</sup>
- nenin 35 të K.Pr.Civile lidhur me përbërjen e trupit gjyqësor;<sup>3</sup>
- nenet 71, 72 dhe 73 të K.Pr.Civile lidhur me vlerësimin që nuk ka papajtueshmëri për gjykimin e një çështje të caktuar;<sup>4</sup>
- nenin 16 të K.Pr.Civile lidhur me të drejtën që ka gjykata për të bërë një cilësim të ndryshëm të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët;<sup>5</sup>
- nenin 510/e të K.Pr.Civile lidhur me kuptimin e titullit ekzekutiv;<sup>6</sup>
- nenin 106 të K.Pr.Civile lidhur me ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore,<sup>7</sup> etj.

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse.

<sup>1</sup> Vendimi nr. 8611, datë 20.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>2</sup> Vendimi nr. 6616, datë 10.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimi nr. 5588, datë 30.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimi nr. 632, datë 04.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>3</sup> Vendimi nr. 6616, datë 10.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>4</sup> Vendimi nr. 632, datë 04.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>5</sup> Vendimi nr. 3797, datë 27.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimi nr. 8767, datë 24.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>6</sup> Vendimi nr. 688 Akti, datë 12.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>7</sup> Vendimi nr. 7361, datë 04.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vendimi nr. 8767, datë 24.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vendimi nr. 3797, datë 27.05.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Në vendimin me objekt dëmshpërblim që rrjedh nga marrëdhëniet e punës, gjyqtarja referon nenin 143 të K.Punës mbi afatin e njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës; nenin 144 të K.Punës, lidhur me procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës; nenin 146 të K.Punës në lidhje me zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të arsyeshme; nenin 138/4 të K.Punës lidhur me pushimin e punëmarrësit në rast të transferimit të ndërmarrjes;
- Në vendimin me objekt shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror që vjen për shkak të aksidentit automobilistik, gjyqtarja fillimisht identifikon normat relevante për zgjidhjen e çështjes, nenet 608 dhe 609<sup>8</sup> të K.Civil, nga ku identifikon kushtet që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative për të lindur përgjegjësia për shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor. Më tej, gjyqtarja, identifikon dhe analizon dispozita ligjore nga ligje të tjerë të posaçëm apo akte të tjera ligjore, lidhur me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkimeve në padi (ligji nr. 10 067, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, rregullorja nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”);
- Në vendimet me objekt padi detyrimi, gjyqtarja identifikon normën relevante në lidhje me të drejtën e bashkëpronarit për të kërkuar të ardhurat e sendit të përbashkët (neni 200/a i K.Civil), si dhe nenin 8/1 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, lidhur me të drejtën e parablerjes;<sup>9</sup> në vendimin tjetër me objekt padi detyrimi (përmbushje detyrimi kontraktor) gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore të aplikueshme në pjesën titulluar “Baza ligjore e aplikueshme” (nenet 705, 659, 681, 682, 683, 690 dhe 698 të K.Civil);<sup>10</sup> në një vendim tjetër gjyqtarja identifikon nenin 850 të K.Civil, i cili jep kuptimin e kontratës së sipërmarrjes, nga ku gjyqtarja pas analizës që i bën rrethanave faktike, arrin në përfundimin që pavarësisht emrit të kontratës në fjalë, ajo përbën një kontratë sipërmarrje, si dhe nenin 560 të K.Civil, që jep kuptimin e hipotekës, për të konkluduar nëse mund të kërkohej pavlefshmëria e kontratës së hipotekës, në një moment që ky mjet për garantimin e detyrimit ka rënë nga fuqia.<sup>11</sup>

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet e vëzhguara nuk rezulton të jetë evidentuar konflikt i normave procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe bën përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi.

<sup>8</sup> Të njëjtat dispozita ligjore identifikohen si relevante për zgjidhjen e çështjes civile edhe në vendimin nr. 6616, datë 10.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror për shkak të deklaratave të dhëna publikisht.

<sup>9</sup> Vendimi nr. 8767, datë 24.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>10</sup> Vendimi nr. 632, datë 04.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>11</sup> Vendimi nr. 7361, datë 04.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtarja në përputhje me rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes objekt shqyrtimi, referon, citon dhe interpreton norma të ligjit material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të arritura lidhur me zbatimin e tyre në zgjidhjen e çështjes.

Përgjithësisht, në vendimet e vëzhguara rezulton se interpretimi i normës juridike bëhet duke identifikuar qëllimin e normës, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë që të gjejë zbatim dispozita, në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në gjykim. Në mënyrë më specifike, evidentohet se gjyqtarja interpreton dispozita të ligjit material:

- Në interpretim të dispozitave materiale (*neneve 608-609 të K.Civil*) analizon institutin e dëmit jashtëkontraktor, duke u ndalur në kuptimin dhe kushtet e ekzistencës së tij (*paligjshmëria e veprimit ose mosveprimit; dëmi; faji; lidhja shkakësore midis veprimit/mosveprimit të paligjshëm dhe pasojës/dëmit të ardhur*),<sup>12</sup> si dhe analizon në mënyrë të mëvetësishme secilin prej kushteve të ekzistencës së dëmit jashtëkontraktor. Gjyqtarja trajton kriteret që duhet të vlerësojë gjykata për të përcaktuar vlerën e dëmshpërblimit, referuar për këtë nenit 647/a të K.Civil, analizon kuptimin dhe rëndësinë e shpërblimit monetar të dëmit dhe përgënjeshttrimin të deklarimeve, zhvillon analizën për të gjithë kushtet dhe/ose nënkushtet e identifikuar në analizën teorike të institutit të dëmit jashtëkontraktor dhe shpërblimit të tij, në faktet e çështjes objekt gjykimi;
- Referuar interpretimit literal të bërë dispozitave materiale (*neneve 138, 144 dhe 146 të K.Punës*), gjyqtarja konkludon se ristrukturimi në përputhje dhe me nenin 144 të K.Punës (*pjesë në të cilën gjyqtarja analizon nenin 144 të K.Punës në kuadër të ndryshimeve me ligjin 16/2015*), si dhe me nenin 138 të tij, përbën shkak të vlefshëm dhe të arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës, në rast se provohet se ai është kryer realisht, sikurse provohet në rastin në fjalë. Nga ana e gjyqtarës analizohet neni 143 i K.Punës, në lidhje me respektimin e afatit të njoftimit nga ana e palës punëdhënëse.
- Analizon kontratën e sipërmarrjes, parashikuar nga neni 850 i K.Civil, duke evidentuar si elementë të saj: shkakun, i cili konsiston në shkëmbimin e një sendi të tashëm me një send të ardhshëm; objektin i cili konsiston në realizimin e një sendi të ardhshëm, rrezikun e sipërmarrësit, si dhe pagimin e çmimit. Në kuadër të analizës së kryer, gjyqtarja thekson në veçanti se kontrata e sipërmarrjes në vetvete nuk është mjet për fitimin e pronësisë. Në të njëjtin vendim gjyqësor, gjyqtarja analizon të drejtën e hipotekës, referuar nenit 560 të

<sup>12</sup> Vendimi nr. 5588, datë 30.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Vendimi nr. 6616, datë 10.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

K.Civil, duke dhënë kuptimin e saj referuar ligjit si e drejtë reale, si dhe funksionin e saj si mjet garantimi.

- Interpreton nenin 200/a të K.Civil, në lidhje me të drejtën e bashkëpronarit për të përfituar nga të ardhurat e sendit, por gjithnjë në përputhje dhe në përpjestim me pjesën takuese të bashkëpronarit, si dhe interpreton nenin 8/1, gërma “a” të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish-pronarëve”, nga ku konkludon, se e drejta e qirasë për përdorimin e truallit i njihet subjektit të shpronësuar vetëm për pjesën e truallit të zënë me ndërtesë, e cila përdoret për interesa shtetërore, deri në privatizimin e saj.<sup>13</sup>
- Analizon kontratën e huasë dhe rëndësinë e marrëdhënies kontraktore mes palëve.<sup>14</sup>

Sa i përket ligjit procedural, referon dhe interpreton nenin 510/e të K.Pr.Civile, i cili duke qenë një dispozitë ligjore referuese, referon në ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, si dhe në kuptim të nenit 511/ç të K.Pr.Civile analizon kompetencën tokësore në kuadër të lëshimit të urdhrat të ekzekutimit; analizon nenin 32 të K.Pr.Civile në lidhje me të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për t’u dëgjuar mbi themelin e pretendimeve në lidhje me një mosmarrëveshje (legjitimitimi formal/e drejta për të ngritur padi); interpreton nenin 106 të K.Pr.Civile në lidhje me disponimin për shpenzimet gjyqësore; referon në vendimet gjyqësore (pa referuar në dispozita konkrete ligjore procedurale) aspekte procedurale gjatë procesit gjyqësor, konkretisht: të drejtën e palës për sigurimin e padisë; kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi për njërën nga palët paditëse dhe pushimin e gjykimit në këtë rast; të drejtën e palës për të saktësuar objektin e padisë gjatë gjykimit (vetëm në një vendim gjyqësor citohet edhe baza ligjore, neni 185 i K.Pr.Civile);<sup>15</sup> kalimin procedural për njërën nga palët paditëse, për shkak se ka ndërruar jetë gjatë gjykimit, si dhe lidhur me kërkesat e palëve për marrjen e provës (përfshi edhe provën me ekspert).

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, gjyqtarja zbaton parimin e procesit të rregullt ligjor, pa përmendur shprehimisht elementë të këtij parimi, por duke iu referuar kontekstit të arsytimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejt aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, kontradiktoritetin, disponibilitetin e padisë nga pala paditëse në përcaktim ne objektit të mosmarrëveshjes, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim. Në të drejtën materiale civile referon në parime të rëndësishme, si: kontrata është ligj për palët; në interpretimin e kontratës duhet pasur parasysh qëllimi i palëve; parimin “*Lex specialis derogate generalis*” në bazë të të cilit kur në një gjykim zbatohen njëkohësisht dy ligje (materiale apo procedurale), atëherë do të zbatohet ligji i posaçëm; parimin e prezumimit të fajësisë në të drejtën civile.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese,

<sup>13</sup> Vendimi nr. 8767, datë 24.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>14</sup> Vendimi nr. 632, datë 04.02.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>15</sup> Vendimi nr. 5588, datë 30.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- *Në vendimin civil me objekt shpërblim që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës*, gjyqtarja referon në vendimin unifikues nr. 9, datë 09.03.2006, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në kuadër të detyrimit të gjykatës për të bërë një cilësim të saktë të fakteve të çështjes. Gjyqtarja, në të njëjtin vendim, referon edhe në vendimin unifikues 19/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të konkluduar nëse pala punëdhënëse ka respektuar afatin e njoftimit dhe procedurën, pasi në rast të respektimit të tyre, pala përjashtohet nga përgjegjësia për dëmshpërblim ndaj punëmarrësit.
- *Në vendimin civil me objekt shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror që ka ardhur për shkak të veprimit të paligjshëm (aksident)*, gjyqtarja referon në vendimin unifikues nr. 12, datë 14.09.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me zbatimin e neneve 608, 609, 625, 643/a e vijues të K.Civil, duke u shprehur për subjektet (*legjitimimi aktiv*) që kanë të drejtën për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror të pësuar, figurën e dëmit biologjik, figurën e dëmit moral dhe atij ekzistencial, metodologjinë e përlllogaritjes së masës së dëmshpërblimit, etj. Ky vendim është referuar edhe në një vendim tjetër, në lidhje me barrën e provës, si dhe të ekzistencës së lidhjes shkakësore, si kusht për ekzistencën e fajit.<sup>16</sup>
- Në një vendim tjetër, gjyqtarja referon në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 539, datë 31.03.2005, ku analizon se përcaktimi i legjitimitetit real bëhet mbi bazën e të drejtës materiale dhe mungesa e tij e bën pretendimin të pathemeltë dhe për rrjedhojë, të papranueshëm për gjykatën.
- Gjyqtarja, përveç vendimit unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, referon edhe në vendimin unifikues nr. 5, datë 30.10.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me analizën që i bën kërkimeve të palëve, për të kuptuar drejt natyrën e kërkimit të bërë nga pala paditëse.
- *Në vendimin civil me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor për shkak të deklaratave publike*, gjyqtarja përdor jurisprudencën e pasur të GJEDNJ në lidhje me lirinë e shprehjes (neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 10 i KEDNJ), ku citohen Vendimi 16/2004 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar. Gjyqtarja, duke analizuar kufijtë e lirisë së shprehjes referuar për këtë nenit 17 të Kushtetutës dhe nenit 10 të KEDNJ, evidenton mbrojtjen e reputacionit dhe referon në vendimet nr. 7, datë 07.06.2010 dhe nr. 8, datë 01.07.2011 të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimet Chauvy kundër Francës dhe Axel Springer AG kundër Gjermanisë. Gjyqtarja duke sjellë në vëmendje vendimin Von Hannover kundër Gjermanisë, në kuadër të elementëve të elaboruar për efekt të vlerësimit të balancës midis lirisë së shprehjes dhe të drejtës së reputacionit, evidenton si elementë për t'u trajtuar: Statusi i subjekteve të përfshira (*referon vendimet Castells kundër Spanjës, Jerusalem kundër Austrisë, Lingens kundër Austrisë, Nikula kundër Finlandës, Lesnik kundër Sllovakisë*); qëllimi i deklaratave (*vendimi Fleury kundër Francës*); natyra e deklaratimeve dhe kontributit në interesin publik

---

<sup>16</sup> Vendimi nr. 6616, datë 10.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

(*Barata Monteiro da Costa Nogueira dhe Patricio Pereira kundër Portugalisë*), mjete i përdorur; sjellja e mëparshme e subjektit të cenuar (*Egeland dhe Hanseid kundër Norvegjisë*).

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes dhe në disa raste ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore unifikuese dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese si dhe praktikën e konsoliduar të GJEDNJ.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.B Arsyetimi ligjor**

### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet përfundimtare, në përgjithësi është e thjeshtë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në procesin civil, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine,<sup>17</sup> përgjithësisht të etiketuara në kllapa pas termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe.

Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Evidentohet në mënyrë të veçantë në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

<sup>17</sup> Të tilla si: “buona fede”, “apriori”, “ratio legis”, “ratione personae”, “condicio sine qua non”, “lex specialis”, “lex specialis derogate generalis”.



Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin. Por, evidentohet se jo rrallë gjyqtarja përdor fjali të gjata, me qëllim që të mos ndërpresë mendimin. Vendimi është i organizuar me paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë së vendimit.

Në vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja pasqyron elementë proceduralë si: kompetenca, juridiksioni, të cilat nisur nga përmbajtja e vendimit, nuk kanë qenë të diskutueshme nga palët apo rrethanat. Në tërësi, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme e përdorur në arsyetim dhe mënyra e organizimit të vendimit, mundëson lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet gjyqësore që i nënshtrohen kësaj analize, gjyqtarja ndjek në hartimin e tyre një strukturë të qartë, të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Rezulton se gjyqtarja ka një metodologji të qartë sipas pjesëve përbërëse të vendimit. Konkretisht, në mënyrë më specifike, konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, baza ligjore, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

*Pjesa përshkuese-arsyetuese* është e ndarë në disa pjesë, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (ii) rrethanat e fakteve të çështjes, siç rezultojnë nga provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (iii) vlerësimi i gjykatës, ku pasi zhvillohet analiza e ligjit të zbatueshëm, marrin në shqyrtim kërkimet/prapësimet e palëve, si dhe shpenzimet gjyqësore. Në një pjesë të vendimeve gjyqësore, gjyqtarja e fillon arsyetimin ligjor, duke parashtruar fillimisht çështjet për diskutim/pyetjet ligjore dhe më pas vijon analizën ligjore, duke i dhënë përgjigje secilës pyetje të parashtruar.

*Në pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimit është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm

disponimi i gjykatës, por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore, apo parashikimi i titullit ekzekutiv të vendimit me marrjen formë të prerë të tij, pas ndryshimeve në K.Pr.Civile. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi konstatohet e drejta e ankimit, e cila fillon pas marrjes dijeni në lidhje me arsyetimin e vendimit. Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### ***1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj edhe provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtares për provueshmërinë e fakteve konkrete. Përjashtimisht, vetëm në njërin prej vendimeve gjyqësore nuk ka analizë ligjore, pasi nisur nga vlera e objektit të kërkimit, gjyqtarja ka aplikuar nenin 310/II/3 të K.Pr.Civile.<sup>18</sup>

Gjyqtarja zhvillon analizën juridike për secilin kërkim të ngritur në kërkesëpadi (*ose pasi ka parashtruar çështjet/pyetjet ligjore për diskutim*), ku integron analizën e lidhjes shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, ligjit përkatës dhe mënyrën e aplikimit të tij në rrethanat konkrete, për të konkluduar mbi zgjidhjen përkatëse. Kjo analizë e integruar rezulton veçanërisht në disa vendime:

- Në vendimin nr. 7361, datë 04.11.2019, gjyqtarja fillimisht konstaton çështjet që shtrohen për diskutim për efekt të zgjidhjes së mosmarrëveshjes objekt gjykimi, duke evidentuar si të tilla: shkakun e vërtetë të mosmarrëveshjes, natyrën e kontratës objekt gjykimi, nëse mund të pretendohet pavlefshmëria e kontratës së hipotekimit, kur kjo e fundit ka rënë nga fuqia. Në lidhje me shkakun e mosmarrëveshjes, pasi jepet përkufizimi i tij referuar nenit 154 të K.Pr.Civile dhe vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vijohet me përcaktimin e shkakut të vërtetë të mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

<sup>18</sup> Cituar përmbajtja më sipër, kur është analizuar aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në këtë aspekt, evidentohet se në thelb, kërkimi i paditësve konsiston në njohjen e së drejtës së pronësisë dhe rrjedhimisht ata duhet të vërtetojnë të drejtën e pronësisë për pasuritë për të cilat kërkojnë njohjen pronar. Për këtë qëllim, merret në shqyrtim kontrata objekt gjykimi, titulluar “*Kontratë shkëmbimi me kusht*”. Pas analizës së kushteve të saj, nga përmbajtja e të drejtave dhe detyrimeve, konkludohet se ajo përfaqëson një kontratë sipërmarrje, e cila në vetvete nuk ka për qëllim kalimin e pronësisë dhe nuk përfaqëson mjet për fitimin e pronësisë, por vetëm gjeneron të drejtë posedimi. Rrjedhimisht, kërkimi për njohjen pronar konkludohet të jetë i pabazuar. Në vijim, analizohet kërkimi për pavlefshmërinë e kontratës së hipotekës. Në këtë kuadër, fillimisht sqarohet kuptimi dhe funksioni i kontratës së hipotekës, si një mjet garantimi. Mbi këtë bazë, duke qenë se kontrata e hipotekës rezultoi t’i ketë sjellë efektet e saj dhe të ketë rënë nga fuqia, konkludohet se nuk ka legjitimim në parashtrimin e kërimit për pavlefshmëri. Së fundi, merret në shqyrtim kërkimi lidhur me heqjen dhe fshirjen e pronësisë së palës së paditur në regjistrat e Kadastrës. Në analizë të këtij kërkimi, duke mbajtur në konsideratë se në këtë drejtim nuk verifikohet lindja e konfliktit, si dhe pozitën procedurale të ASHK në gjykim, konkludohet për pabazueshmërinë e tij. Në përfundim, vendimi gjyqësor konkludon për pabazueshmërinë e padisë së paraqitur dhe rrjedhimisht, ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore palës paditëse.

- Në vendimin nr. 6616, datë 10.10.2019, gjyqtarja fillimisht konstaton çështjet që shtrohen për diskutim për efekt të zgjidhjes së mosmarrëveshjes objekt gjykimi, duke evidentuar si të tilla: nëse në çështjen objekt gjykimi verifikohet përgjegjësia për shkaktimin e dëmit jopasuror dhe ku konsiston ky dëm; cilët janë kriteret ku do mbështetet gjykata për përcaktimin e dëmshpërblimit përkatës; a verifikohen rrethanat për aplikimin e detyrimit për përgënjeshtim dhe nëse po, cila do të jetë forma e tij. Në lidhje me çështjen e parë, evidentohen fillimisht kushtet kumulative për përgjegjësinë jashtëkontraktore (*paligjshmëria e veprimit ose mosveprimit; dëmi; faji; lidhja shkakësore midis veprimit/mosveprimit të paligjshëm dhe pasojës/dëmit të ardhur*) dhe më pas vijohet me analizën e secilit prej tyre, fillimisht në pikëpamje teorike dhe më pas, në raport me rrethanat konkrete të çështjes. Kështu, merret në analizë ekzistenca e veprimit të paligjshëm, ku trajtohet liria e shprehjes përballë të drejtës së reputacionit, duke mbajtur në konsideratë veçanërisht jurisprudencën e GJEDNJ. Në këtë këndvështrim, evidentohen dhe analizohen: Statusi i subjekteve të përfshirë; Qëllimi i deklaratave; Natyra e deklarimeve dhe kontributit në interesin publik; Mjeti i përdorur; Sjellja e mëparshme e subjektit të cenuar. Më tej, merret në analizë ekzistenca e dëmit, duke mbajtur në konsideratë vendimin unifikues nr. 12/2007; ekzistenca e fajit, duke mbajtur në konsideratë parimin e prezumimit të fajësisë në të drejtën civile; si dhe lidhja shkakësore, referuar sërish vendimit unifikues nr. 12/2007. Në përfundim të analizës së secilit prej këtyre kushteve, konkludohet për verifikimin e tyre, e rrjedhimisht vijohet me çështjen e dytë, kriteret që duhet të mbajë në konsideratë gjykata në përcaktimin e dëmshpërblimit monetar. Në këtë kuadër, referuar nenit 647/a të K.Civil, analizohen: mënyra, forma dhe koha e përhapjes së deklaratave cenuese; respektimi i etikës; forma e fajit; fakti nëse thëniet janë të vërteta ose jo; fakti nëse deklaratimet e palës së paditur paraqesin çështje me interes publik; veprimet e kryera prej palës së paditur për të zvogëluar/minimizuar dëmin.

Në përfundim të analizës së mëvetësishme të këtyre elementëve, konkludohet mbi vlerën e dëmshpërblimit, nisur nga parimi se dëmi jopasuror ka përgjithësisht karakter simbolik. Së fundi, merret në analizë çështja e tretë e shtruar për diskutim, nëse verifikohen rrethanat për aplikimin e detyrimit për përgënjeshttrim, e nëse po, forma përkatëse në çështjen objekt gjykimi. Kështu, duke mbajtur në konsideratë paligjshmërinë e deklaratave dhe efektet e tyre në nderin, emrin dhe reputacionin personal dhe publik të subjektit, konkludohet se ato nuk duhet të përsëriten në të ardhmen. Ndërkohë, sa i takon vlerësimin të nevojës dhe aktualitetit të përgënjeshttrimin, analizohen aspekte si: koha, konteksti, qëllimi i deklarimeve të palës së paditur, si dhe veprimet që kanë pasuar ato. Mbi bazë të kësaj analize, konkludohet për papërshtatshmërinë e aplikimit të detyrimit për përgënjeshttrim. Në përfundim, vendimi gjyqësor konkludon për bazueshmërinë e pjesshme të padisë.

- Në vendimin nr. 8767, datë 24.12.2019- gjyqtarja fillimisht analizon kuptimin e nenit 200/a të K.Civil, duke shpjeguar se sipas këtij neni, çdo bashkëpronar ka të drejtë të përfitojë nga të ardhurat e sendit të përbashkët, nëse ky i fundit përdoret nga të tretët, por gjithnjë në përputhje dhe në përpjesëtim me pjesën takuese të tij. Mbi këtë bazë, evidentohet se paditësit mund të pretendojnë të drejta qiraje mbi pasuritë në bashkëpronësi, vetëm për pjesën përkatëse takuese. Në vijim, gjyqtarja merr në analizë nenin 8/1 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, duke shpjeguar se referuar kësaj dispozite, e drejta për përdorimin e truallit i njihet subjektit të shpronësuar vetëm për pjesën e truallit të zënë me ndërtesë, e cila përdoret për interesat shtetërore, deri në privatizimin e saj. Mbi këtë bazë, konkludohet se pala paditëse nuk mund të pretendojë qiranë e përdorimit deri në ushtrimin e së drejtës së parablerjes për sipërfaqen e truallit të lirë, pasi e drejta e parablerjes i është njohur vetëm për ndërtesat. Së fundi, evidentohet parashikimi i pikës 6, seksioni VII të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, e në analizë të tij vendimi konkludon për pabazueshmërinë e kërimit të palës paditëse edhe për një shkak tjetër, mungesës së legjitimitetit pasiv material.
- Në vendimin nr. 3797, datë 27.05.2019, gjyqtarja fillimisht merr në analizë procedurën e ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënies së punës në themel të kërimit. Në vijim, citohen nenet 138 dhe 146 të K.Punës dhe analizohen ndryshimet që solli ligji 136/2015 në konceptimin e nenit 144 dhe 146 të K.Punës. Konkretisht, theksohet mospërcaktimi i shkakut në shkresën njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës si zgjidhje kontrate me shkak të paarsyeshëm dhe analizohet koncepti i ristrukturimit në këtë këndvështrim. Mbi bazën e kësaj analize konkludohet për zgjidhjen në mënyrë “*të natyrshme*” të kontratës së punës. Së fundi, gjyqtarja merr në shqyrtim shpenzimet gjyqësore.
- Në vendimin nr. s’ka, datë 12.03.2019, gjyqtarja fillimisht citon nenin 510/e të K.Pr.Civile dhe më pas vijon me analizën e faturave tatimore të shitjes objekt gjykimi, për të cilat konstaton se: ato përmbajnë konsumin e energjisë elektrike të abonentit debitor për periudhat respektive ; janë nxjerrë në përputhje me modelin e përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; nëpërmjet përcaktimit të ligjit të posaçëm, ngarkohen zyrat e përbarimit për ekzekutimin e tyre. Në këto kushte, konkludohet se kërkesa për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për faturat tatimore të shitjes së energjisë elektrike objekt gjykimi është e bazuar. Në vijim, analizohet kërkitimi për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për

kamatëvonesat përkatëse mbi detyrimin e rrjedhur prej secilës faturë. Duke mbajtur në konsideratë se kamatëvonesat nuk parashikohen si pjesë e faturës, si dhe se nuk gjen zbatim ligji nr. 48/2014, konkludohet për pabazueshmërinë e këtij kërkimi, e për rrjedhojë për rrëzimin e kërkesës në këtë pjesë.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse, në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u parashtruar në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit dhe më pas duke u marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre, në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimin konkret. Duke u marrë në shqyrtim dhe duke analizuar jo në një pjesë të veçuar të arsyetimit, por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, pretendimet e palëve marrin një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose në prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme, si pjesë e arsyetimit të vendimit.

**Në tërësi**, në vendimet gjyqësore të analizuara, analiza ligjore në lidhje me kërkimet objekt padie dhe prapësimet e palës së paditur është gjithëpërfshirëse dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019,<sup>19</sup> rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 25 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” dhe “*Civile pa palë kundërshtare*”. Duke iu referuar objektit të çështjeve të pasqyruara në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se kërkesat janë: me objekt “*Kundërshtim i veprimeve përmbartimore*”, për të cilat neni 610 i K.Pr.Civile, parashikon një afat prej 20 ditësh për përfundimin e gjykimit; me objekt “*Sigurim padie*”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 202 të K.Pr.Civile, duhet të shqyrtohen nga gjykata brenda 5 ditëve dhe me objekt “*Kërkesë për ndihmë juridike dytësore*”, për të cilën parashikohet një afat prej 5 ditësh për përfundimin e tyre, sipas nenit 22 të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 25 çështje<sup>20</sup> për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 18 (tetëmbëdhjetë)<sup>21</sup> prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (18 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (25 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 72% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja parashtron se duke marrë në konsideratë që një gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, merr për shkak të shortit një numër tepër të konsiderueshëm çështjesh gjyqësore, çka rëndon dhe mbingarkon kalendarin e punës së përditshme të gjykatës, duke marrë në konsideratë edhe faktin se shumica e çështjeve civile ka një ndërgjyqësi të përbërë nga shumë palë të ndryshme (*në numër e cilësi juridike*), vetë palët paraqesin kërkesa të ndryshme lidhur me shtimin, saktësimin, ndryshimin e objektit të kërkesëpadsisë, të vlerës së objektit të padsisë, të palëve ndërgjyqëse, paraqesin kërkesa për shtyrje (*nëpërmjet raporteve mjekësore, etj*), nevoja për kryerjen e ekspertimeve në fusha të ndryshme, mospërgjigja në kohë e shkresave zyrtare nga ana e institucioneve të ndryshme shtetërore, mosmarrja në kohë e të gjitha provave shkresore, apo e dokumenteve të kërkuara edhe tek të tretët, etj., rrethana këto të cilat sigurisht që kanë ndikuar në disa raste në pamundësinë objektive për përfundimin e gjykimeve brenda afatit të përcaktuar në ligj. Më gjithë kujdesin dhe përkushtimin maksimal në përfundimin e proceseve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm ligjor, në kudër edhe të gjykimit të drejtë e të rregullt ligjor, për shkaqe dhe rrethana të pavarura nga gjykata, kjo e fundit është e detyruar të vijojë gjykimin me qëllimin e vetëm dhe të patjetërsueshëm për një hetim gjyqësor të plotë, të drejtë, objektiv, të gjithanshëm, në arritjen e zgjidhjes ligjore të çështjeve në gjykim.

Në detyrën e vlerësuesit është bërja e analizës së të dhënave statistikore në mënyrë të tillë që të shmangen përfundime që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë

<sup>19</sup> Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. 437/20 Prot., datë 18.12.2020.

<sup>20</sup> Në Tabelën nr. 1 çështjet me numër rendor 26, 34, 50, 70, 80, 127, 139, 160, 174, 175 dhe në Tabelën nr. 2 çështjet me numër rendor 1, 10, 12, 49, 52, 57, 67, 73, 75, 77, 80, 293, 399, 442, 448.

<sup>21</sup> Në Tabelën nr. 1 çështjet me numër rendor 26, 34, 50, 70, 80, 127, 139, 160, 174 dhe në Tabelën nr. 2 çështjet me numër rendor 52, 73, 75, 77, 80, 293, 399, 442, 448.

të gjitha të dhënat e burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 18 çështjet e shqyrtuara jashtë afatit ligjor, rezulton se çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbare”, përbëjnë 13 çështje, të cilat respektivisht janë gjykuar për 384 ditë, 186 ditë, 255 ditë, 183 ditë, 22 ditë, 7 ditë, 96 ditë, 6 ditë, 11 ditë (*çështje të pasqyruar në tabelën nr.1*), 38 ditë, 204 ditë, 67 ditë, 3 ditë (*çështje të pasqyruar në tabelën nr.2*), në tejkallim të dukshëm të afatit 20 ditor.

Në lidhje me afatin e gjykimit në çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbare” neni 610 i K.Pr.Civile parashikon se ato shqyrtohen brenda 20 ditëve, në dhomë këshillimi, dhe kur e vlerëson të arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprime të tilla si: njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla; njoftimin e ankimit dhe akteve shoqëruese përmbare gjyqësor dhe lënien e afatit për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave; caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal për të mundësuar kryerjen e njoftimit, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t’u dëgjuar në seancë.

Vetëm me kryerjen e këtyre veprimeve minimale dhe të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces, pa përllogaritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbare gjyqësor për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, afati ligjor 20 ditor i gjykimit do të rezultonte i tejkalluar. Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykimin e shkallës së parë që shqyrton ankimin në themel ka parashikuar afatin 20 ditor të shqyrtimit, për gjykatën e apelit që shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbi shkaqet e ankimit dhe kryesisht duke u bazuar në aktet e dosjes, ka parashikuar në nenin 610 të K.Pr.Civile një afat më të gjatë gjykimi prej 30 ditësh ose 45 ditësh, në rast se gjykata vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes në praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuar në ligj.

Nëse afati ligjor i shqyrtimit të çështjeve me këtë objekt, do të ishte i njëjtë me afatin maksimal që K.Pr.Civile parashikon për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, përsëri afati gjatë të cilit janë shqyrtuar çështjet që i përkasin kësaj kategorie rezulton i tejkalluar, me përjashtim të 5 çështjeve (*me nr. rendor 80, 127, 160, 174, 448,* ), pasi ato janë përfunduar për një periudhë kohe e cila fillon nga 1 muaj e 28 ditë, e deri në 1 vit e 1 muaj e 9 ditë.

Në çështjet me objekt “Sigurim padie”, nga 6 çështje, 3 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor 5 ditor, duke përfunduar për 7 ditë dhe 8 ditë.<sup>22</sup> Evidentohet se në një rast, vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e shortimit me vonesë të çështjes. Konkretisht, çështja me numër rendor 52, është regjistruar në datën 03.07.2019 dhe është shortuar në datën 05.07.2019 dhe nëse afati i gjykimit do të llogaritej nga data që i është caktuar gjyqtares me short, atëherë kjo çështje do të kishte përfunduar për 5 ditë, pra brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 202 të K.Pr.Civile. Në këto 3 çështje afati i gjykimit 5 ditor është tejkalluar me 2 deri në 3 ditë.

---

<sup>22</sup> Çështjet me numër rendor 73 dhe 77.

Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, do të përjashtoheshin çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (2 ditë, 3 ditë, 6 ditë dhe 7 ditë), atëherë, do të rezultonte se raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (12 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (25 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar **48% të çështjeve jashtë afatit ligjor**.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të ulët të çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë të lartë çështjesh në periudhën e vlerësimit, 715 çështje, nga të cilat 134 të mbartura nga viti 2018 dhe 581 të regjistruara në vitin 2019, si dhe ka përfunduar 661 çështje.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet dy nivele më lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, në referim kjo edhe të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet "21-30 %", duke e pikëzuar me 9 pikë.*

#### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar në total 636 (gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) çështje (pa përfshirë këtu çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi), nga të cilat 167 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) çështje të kategorisë "Civile të përgjithshme me palë kundërshtare", 438 (katërqind e tridhjetë e tetë) çështje të kategorisë "Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare" dhe 31 (tridhjetë e një) çështje të kategorisë "Marrëdhënie pune", për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD, përcakton këto standarde minimal kohore: jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile në gjykatën e shkallës së parë dhe jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, rezulton se nga 636 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 189 prej tyre ose **29.7% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi**.



Gjyqtarja ka bërë prezent një sërë shkaqesh në Formularin e Integruar të Vlerësimit dhe të pasqyruara në raportin analitik, që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të cilat lidhen me ngarkesën e lartë dhe rrethanat objektive në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Gjyqtarja ka shpjeguar në mënyrë të detajuar shkaqet e mbarimit tej afateve orientuese standard minimal kohor për disa prej tyre, duke vlerësuar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe objektive, si: natyra e çështjes, sjellja e palëve, mungesa e konfirmimit të njoftimit të palëve, apo vonesat në kthimin e përgjigjeve në kuadër të marrjes së provave apo të informacioneve zyrtare të nevojshme e të detyrueshme për zgjidhjen sa më të drejtë dhe objektive të mosmarrëveshjes gjyqësore.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, sipas një llogaritjeje vetëm matematikore, përqindja e mësipërme e çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor, pikëzohet me 3 pikë. Por, referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në pikëzim maksimal, duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit. Në rastin konkret, sa i përket treguesit sasior të punës së gjyqtares (*gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo më pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare*), rezulton se në vitin kalendarik 2019 gjyqtarja ka përfunduar në total 208 çështje me palë kundërshtare, pra 73% më shumë së treguesi sasior i përcaktuar në vendimin nr. 261/2 të vitit 2010, çka tregon për një numër të lartë çështjesh të përfunduara. Sipas të dhënave statistikore, konstatohet ngarkesë e lartë, pasi për vitin kalendarik 2019 rezultojnë 581 çështje të caktuara si relatores dhe 134 çështje të mbartura nga viti i mëparshëm, me një ngarkesë të përgjithshme prej 715 çështjesh, nga të cilat ajo ka përfunduar 661 çështje.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve civile për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 29.7%, si dhe shkaqeve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit sipas burimeve të vlerësimit, vlerësoj se ky tregues duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:*** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet në nivelin “Mbi 10-20%”, duke e pikëzuar me 4 pikë.

#### ***2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.***

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor

në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve. Konkretisht,

Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 233,5 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 44.3 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 173.5 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mbi mesatar, duke renditur si shkak që ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve natyrën e çështjeve, vështirësitë me natyrë procedurale, të cilat ndikojnë objektivisht në ecurinë normale të një gjykimi.

Duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, vetëm për një kategori, tejkalohet vetëm për 1 muaj 23 ditë, si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja, ky tregues vlerësohet në nivelin maksimal, duke u pikëzuar me 5 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

#### **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (661 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara (581 çështje) brenda vitit kalendarik, është 113.7 %.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “+99%”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsytimit është 4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.**

***2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.***

Referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short dhe të pasqyruara në tabelat përkatëse numri i seancave gjyqësore të zhvilluara për shqyrtimin e çështjes nuk përputhet me numrin e seancave të pasqyruar në kolonën “Nr. i seancave gjyqësore”. Konkretisht:

- Në tabelën nr. 1, çështja me numër rendor 43, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 7 seanca, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 5588 vendimi, datë 30.07.2019, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 6;
- Në tabelën nr. 1, çështja me numër rendor 15, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 7 seancë, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 632 vendimi, datë 04.02.2019, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 4;
- Në tabelën nr. 1, çështja me numër rendor 19, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 17 seanca, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 8767 vendimi, datë 24.12.2019, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 8.

Në datën 14.10.2021, nëpërmjet postës elektronike, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është kërkuar saktësimi i të dhënave të dërguara, duke pasqyruar në kolonën përkatëse vetëm numrin e seancave gjyqësore të zhvilluara për çdo çështje, pa përfshirë në to seancat përgatitore. Nga

informacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,<sup>23</sup> rezulton se në kolonën “Nr. i seancave gjyqësore” janë pasqyruar të gjitha seancat e zhvilluara për çdo çështje gjyqësore, duke përfshirë si seancat përgatitore, ashtu edhe ato gjyqësore. Sistemi me të cilin operon Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (ARK-IT) nuk mundëson evidentimin dhe ndarjen e seancave përgatitore, nga ato gjyqësore.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive” përcaktohet se për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh.

Në kushtet kur në të dhënat e dërguara nga gjykata janë përfshirë jo vetëm seancat gjyqësore, por edhe seancat përgatitore, pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike në mënyrë të ndarë, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikave mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.*

Në mungesë të kësaj të dhëne, referimi do të bëhet ndaj 5 (pesë)<sup>24</sup> nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë” dhe “Marrëdhënie pune”. Rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për kategorinë “Civile me palë kundërshtarë” është 4.5 seanca dhe për kategorinë “Marrëdhënie pune” është 3 seanca. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore është **3.75 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtarja në përgjithësi ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosje burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes (*urdhër kalim në seancë gjyqësore pas ezaurimit të veprimeve përgatitore*), duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile.

Në 5 (pesë)<sup>25</sup> nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se: janë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes civile me palë kundërshtarë me objekt përmbushje detyrimi; 8 (tetë) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes civile me palë kundërshtarë me objekt pagim i qirasë për posedimin; 3 (tre) seanca gjyqësore për përfundimin

---

<sup>23</sup> Informacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nëpërmjet postës elektronike në datën 18.10.2021

<sup>24</sup> Duke përjashtuar çështjen me nr. 688 Akti, datë 12.03.2019, për shkak se i përket kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtarë

<sup>25</sup> Duke përjashtuar çështjen me nr. 688 Akti, datë 12.03.2019, për shkak se i përket kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtarë

e çështjes me objekt marrëdhënie pune; 6 (gjashtë) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes civile me objekt shpërbllim dëmi pasuror dhe jopasuror; 1 (një) seancë gjyqësore (në dhomë këshillimi) për përfundimin e çështjes me objekt padi detyrimi (gjykuar me gjykim të shkurtuar). Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme (*me kërkesë të palës së paditur, për shkak të pamundësisë objektive për t'u paraqitur, për marrjen e akteve nga të tretët, për kryerjen e aktit të ekspertimit, për t'i lënë kohë palëve për t'u njohur me aktin e ekspertimit, për realizimin e kërkesës me shkrim mbi saktësimin e objektit të padisë, për komunikimin e aktit të ekspertimit palëve në mungesë, për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, etj*). Konstatohet gjithashtu se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 20 - 30 ditësh nga njëra-tjetra. Vetëm në disa raste konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht, apo në fund të vitit, periudhë kjo që përkon me procedurën e mbartjes së dosjeve nga administrata. Pra në tërësi, shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesit e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 5 çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.75 seanca dhe gjyqtarja, përgjithësisht, ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e në kohë dhe me efektivitet të tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “*Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*” aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet e shkallës së lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

## ***2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.***

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke proceduar me nxjerrjen e vendimit për kryerjen e veprimeve paraprake, konform nenit 158 të K.Pr.Civile, duke urdhëruar njoftimin e palës së paditur dhe lëshimin e deklaratës së mbrojtjes. Ky akt procedural është i plotë, duke pasqyruar të gjitha urdhërimet dhe kërkesat procedurale për palën e paditur, si deklaratën që duhet të lëshojë, dokumentet dhe provat që duhet të paraqesë dhe në sa kopje, afatin e paraqitjes, etj. Pas kryerjes së veprimeve paraprake të sanksionuara me ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Civile, në rastet kur ka qenë e nevojshme, gjyqtarja ka proceduar me nxjerrjen e vendimit për kalimin e çështjes në seancë përgatitore. Pas zhvillimit të seancës përgatitore, gjyqtarja kur ka vlerësuar se çështja ishte e plotë, ka nxjerrë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Rezulton se përgjithësisht, në çështjet e vëzhguara, seancat gjyqësore janë mbajtur nëpërmjet sistemit të regjistrimit audio, si dhe janë pasqyruar në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Evidentohet se në ato raste kur seancat gjyqësore nuk janë zhvilluar audio, ato janë dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të mbajtur me shtypshkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit civil, sipas parashikimeve të K.Pr.Civile. Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për relativimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, relativimin të akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve, marrjes së vendimit në mungesë, të shpalljes së trupit gjykues, verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të caktuara në seancën përgatitore, deklarimit të hapur të shqyrtimit gjyqësor, dhënies së fjalës palëve për të parashtruar pretendimet e tyre dhe provat, lejimit të marrjes së provave në shqyrtim, debatit gjyqësor mbi të gjitha provat, deklarimit të mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënies së fjalës palëve për parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare dhe shpalljes së vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesë më pak se 15 minuta.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 20 pikë.*

## **2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore.**

### **2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.**

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se dosjet janë të renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik (sipas kategorive të akteve) dhe rendin kronologjik (sipas datës së

aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 6 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur kërkesëpadinë, provat, formularin për dorëzimin e provave dhe të dhënat e kontaktit për palën paditëse; deklaratën e mbrojtjes dhe provat respektive, vendimin për kryerjen e veprimeve paraprake, vendimin për caktimin e seancës përgatitore, vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, dëftesat e komunikimit dhe njoftimet, procesverbalin e seancës përgatitore, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, vendimin përfundimtar të gjykatës.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (padija, provat, deklaratat e mbrojtjes, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (aktet e shortit, vendimet për kryerjen e veprimeve përgatitore, vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet gjyqësore përfundimtare).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### 3.A Etika në punë

##### 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren {...} gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit viti 2019, ndaj gjyqtares {...} rezulton të jenë paraqitur dy ankesa, për të cilat pas verifikimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.1139/4 Prot., datë 16.11.2020 dhe nr. 940/11 Prot.,<sup>26</sup> datë 16.12.2020, ka vendosur arkivimin e tyre, pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultatet e verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

I - Ankesa e shtetasit V.B., depozituar në KLGJ me nr. 1227 Prot., datë 25.02.2019, regjistruar në Zyrën e ILD me nr. 940 Prot., datë 08.06.2020, konsiston në pretendimet për shkelje procedurale, shkelje etike dhe shkelje të solemnitetit në gjykimin e çështjes civile me nr.781/534 regjistri, datë 22.09.2017 regjistrimi.

ILD, pas verifikimit të ankesës, ka vendosur arkivimin e ankesës së ankuesit V.B., me vendimin nr. 940/11 Prot., datë 16.12.2020, duke arsyetuar se: “Në lidhje me pretendimet e ankuesit për mosrespektim të dispozitave procedurale lidhur me mënyrën e caktimit të ekspertëve nga gjykata dhe mospranimin për shqyrtim të kundërpadisë së paraqitur nga ankuesit, bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile trajtimi i këtyre pretendimeve është kompetencë e

<sup>26</sup> Vendimet për verifikimin e ankesave janë dërguar nga ILD me shkresat me nr. 2437/7 Prot., datë 17.11.2020 dhe nr. 2437/17 Prot., datë 18.12.2020 dhe u përkasin ankesave të shtetasit V.B. dhe R.K.



*gjykatave me të larta në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit ndaj vendimit gjyqësor përfundimtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë....Për sa i takon pretendimeve për zhvillimin të komunikimit personal dhe konfidencial të gjyqtarës me avokatin e palës paditëse përpara fillimit të seancës gjyqësore, vlerësohet se këto janë të pretendime në terma të përgjithshme të pashoqëruara me argumente dhe prova konkrete edhe nuk pasqyrojnë fakte apo indicie të besueshme të cilat të krijojnë dyshime të arsyeshme se magjistratja {...} ka kryer veprime apo ka shfaqur sjellje që klasifikohen si shkelje disiplinore në kuptim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.... Pretendimet e paraqitura nga ankuesi për sjellje joetike dhe joprofesionale të magjistrates, për të cilat Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nxjerrë edhe vendimin për verifikimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, janë të lidhura me seancat gjyqësore të datave 20.09.2018 dhe 12.11.2018.... Komunikimi i gjyqtarës me palët ndërgjyqëse gjatë gjykimit, i dokumentuar në regjistrimin audio të datës 20.09.2018 dhe në regjistrimin audio të datës 12.11.2018, rezulton të jetë në përputhje me rregullat e solemnitetit të gjykimit të përcaktuara në K.Pr.Civile, në përputhje me drejtimin e hetimit gjyqësor nga kryetari i seancës, një komunikim normal dhe i zakonshëm, me fjalë e shprehje brenda etikës së një komunikimi të gjyqtarit me palët, i pashoqëruar me fjalë apo shprehje kërcënuese të cilat mund të krijojnë perceptimin e ushtrimit të presionit psikologjik sikundër pretendohet në ankesë. Gjykata rezulton të ketë vepruar në përputhje me parashikimet e nenit 178 të K.Pr.Civile. Referuar kësaj dispozite ligjore Kryetari i seancës gjyqësore kujdeset për mbajtjen e rregullit e të qetësisë në seancë. Nisur nga sa më sipër, nga të gjitha aktet e grumbulluara në funksion të verifikimit të ankesës, mungojnë dyshimet e arsyeshme të cilat të justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarës {...} për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102 pika 2 shkronja “dh” e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.*

II- Ankesa e shtetasit R.K., depozituar në KLGJ me nr. 2516 Prot., datë 06.05.2019, regjistruar në Zyrën e ILD me nr. 1139 Prot., datë 15.06.2020, konsiston në pretendime për shkelje procedurale në vënien në dispozicion të provave të paraqitura nga pala e paditur, për të cilat pretendon se i janë vënë në dispozicion me pagesë, si dhe pretendime për dhënien e një vendimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin material.

ILD, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ka vendosur arkivimin e ankesës së ankueses R.K., me vendimin nr. 1139/4 Prot., datë 16.11.2020 duke arsyetuar se: “*Pretendimet e ankuesit i përkasin shqyrtimit gjyqësor të çështjes civile me palë ndërgjyqëse paditës: R.K., i paditur A.M., me objekt pushim cenimi të pronësisë dhe krijimin e servitutit të kalimit për paditësin në pronën e të paditurit, gjykimi i së cilës ka përfunduar me vendimin nr. 6175, datë 09.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ankuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar të legjislacionit material dhe procedural gjatë shqyrtimit gjyqësor është kompetencë e gjykatave më të larta në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit ndaj vendimit gjyqësor dhe konkretisht Gjykata e Apelit Tiranë ku ankuesi ka paraqitur dhe ankimin. Pretendimet e ankuesit për përfitim të padrejtë (korrupsion) të ankuesit*

të paraqitura ndaj magistrates {...}, vlerësohet se janë pretendime të pashoqëruara me argumente dhe prova konkrete të cilat të krijojnë dyshime të arsyeshme se magistratja {...} ka kryer veprime apo kanë shfaqur sjellje që klasifikohen si shkelje disiplinore në kuptim të nenit 103 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Pretendimet e ankuesit janë në terma të përgjithshme dhe nuk pasqyrojnë fakte apo indicie të besueshme se një veprimtari e tillë mund të jetë kryer nga ana e magistrates {...}. Në ankesë mungojnë gjithashtu rrethana dhe fakte konkrete për sjelljen specifike të magistrates {...}, të cilat mund të përbëjnë indicie për realizimin e përfitimeve të padrejta për shkak të funksionit apo duke shfrytëzuar pozicionin e magistratit. Për sa më sipër, në referim të dispozitave që parashikojnë shkeljet disiplinore të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar nuk rezultojnë shkelje me natyrë disiplinore, të parashikuara shprehimisht në nenet 102, 103 dhe 104 të ligjit nr.96/2016. Për sa më sipër, vlerësohet se ankesa e ankuesit nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, kjo referuar natyrës së pretendimeve të parashtruara, referuar nenin 120, pika 1 shkronja “d”, “dh”, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarës në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

**Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

### **3.B Integriteti i gjyqtarës**

#### **3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD dy ankesa, trajtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.1139/4 Prot., datë 16.11.2020 dhe nr.940/11 Prot., datë 16.12.2020, me të cilët është vendosur arkivimi i ankesave pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se nuk plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit të mësipërm.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr.2452/13 Prot., datë 15.06.2021, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

*Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.*

### **3.C Paanësia e gjyqtares**

#### **3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

Në tërësi, referuar të dhënave që konstatohen nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2019–31.12.2019, janë paraqitur 6 (gjashtë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e saj nga gjykimi. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 5 (pesë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 3 (tre) kërkesa janë pranuar.

Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e gjyqtares nga gjykimi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

#### **4.A Aftësia e komunikimit.**

##### **4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces përdor në përgjithësi fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu edhe regjistrimet e seancave në sistemin audio.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në nivel shumë të lartë.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

##### **4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar.**

**4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarëve me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarëve për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.**

##### **4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarëve në programet e formimit vazhdueshëm të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 8 (tetë) ditë trajnimi.

Sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin, *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret, gjyqtarja ka marrë pjesë në 8 aktivitete trajnuese të shtrira në 8 ditë trajnimi, brenda kufijve minimalë dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e saj dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së saj, pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës civile.

***Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime është nga 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019), duke e pikëzuar me 20 pikë.*

#### ***4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e gjyqtares në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, evidentohet se gjyqtarja {...}, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 37, datë 28.02.2019, “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës” është caktuar me cilësinë e udhëheqëses për kandidatin për magjistrat z.Hazbi Balliu (për vitin akademik 2018-2019, për periudhën mars 2019-qershor 2019) dhe me vendimin nr. 112, datë 09.07.2019, “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës” është caktuar me cilësinë e udhëheqëses për kandidaten për magjistrate znj.Alda Sadiku (për vitin akademik 2019-2020, për periudhën korrik 2019-qershor 2020).

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

**Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” rezulton disponueshmëria e gjyqtares, duke e pikëzuar me 5 pikë.

#### **4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të dhëna për vitin 2019 nga dosja personale e gjyqtares në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

**Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 3 pikë.

#### **4.C.ç Publikimet ligjore akademike.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Për pasojë, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me zero pikë.

**Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtares, duke e pikëzuar me 0 pikë.



AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE  
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	93	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	386	Shkëlqyeshëm

**PROPOZIME DHE REKOMANDIME**

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuar në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...}, pavarësisht ngarkesës së çështjeve, duhet të organizojë punën dhe menaxhojë kohën, duke i dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate brenda të cilit ato duhet të gjykohen. Gjyqtarja duhet të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA 1**  
**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE**  
**NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}**  
**PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019 - 31 DHJETOR 2019**

<b>1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Treguesit</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë</b>	<b>Pikët</b>	<b>Të dhëna për metodologjinë</b>
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë

		3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>93</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	21-30 %	9	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë

	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20%	4	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	<b>Tej standardit :</b> Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Më e shkurtër ose e barabartë	15	<b>Koha mesatare:</b>

		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve		Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	<b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> E dobët- 4 pikë

		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit			Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarës:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë

		4. Mendimi përfundimtar i kryetarit			Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtares</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtares :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
<b>C. Paanësia e gjyqtares</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>93</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>	<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>	

<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparencja e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarës	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarës:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4



<b>veprimtari të tjera</b>		3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja			
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtares	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>		<b>386</b>			
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES</b>		<b>Shkëlqyeshëm</b>			

### PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**Kryetare**  
**NAUREDA LLAGAMI**

**Zëvendëskryetar**  
**MAKSIM QOKU**

**Anëtar**  
**MEDI BICI**

**Anëtar**  
**ILIR TOSKA**

**Anëtare**  
**BRIKENA UKPERAJ**

**Anëtare**  
**FATMIRA LULI**

**Anëtare**  
**MARÇELA SHEHU**

**Anëtar/Relator**  
**ERJON MUHARREMAJ**

**Anëtar**  
**ALBAN TORO**

**Anëtar**  
**DRITAN HALLUNAJ**